

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

Nr.Prot: RFO-12-10-2023

Data: 27/11/2023

FTESE PER SHPREHJE INTERESI

I. Objekti i Fteses per Shprehje Interesi

Banka ProCredit Shqiperi eshte e interesuar per nevoja te saj per **blerje, instalim dhe mirembajtje te paisjeve te sigurise te nevojshme per qendren e perpunimit te parave.**

Procesi i prokurimit per kete kerkese, eshte i ndare ne dy etapa:

- 1- **Etapa e Pare:** Te gjitha shoqerite e interesuar jane te ftuara te dorezojne te nenshkruar dhe te vulosur, Aneksin 1 – Deklarata e Kofidencialitetit, bashkengjitur me kete Ftese. Dokumenti duhet te dorezohet elektronikisht i skanuar ne adresen e email: info_procurement@procredit-group.com. Afati final per te dorezuar dokumentin e nenshkruar dhe vulosur elektronikisht eshte **data 05 Dhjetor 2023, ora 16:00.**
- 2- **Etapa e dyte:** Tek te gjitha shoqerite qe do te dorezojne Ankes 1 te nenshkruar sipas afatit te permendur me lart, banka do te dergoje dosjen me te gjitha informacionet e nevojshme, qe ju nevojiten shoqerive per te plotesuar oferten e tyre.

➤ **Aneks nr. 1**

RFO-12-10-2023: Blerje, instalim dhe mirembajtje e paisjeve te sigurise per qendren e perpunimit te cash-it

DEKLARATE KONFIDENCIALITETI

Ne Tirane, sot me date ____/____/2023,

Une i nenshkruari _____, administrator i shoqerise _____, person juridik, i krijuar dhe qe ekziston ne baze te legjislacionit shqiptar, regjistruar ne Regjistrin Tregtar me numer unik identifikimi (NUIS) _____, me seli ne adresen _____, deklaroj si me poshte:

Duke qene se:

- ProCredit Bank sh.a. eshte duke realizuar proceduren e prokurimit me objekt: Blerje, instalim dhe mirembajtje e paisjeve te sigurise per qendren e perpunimit te cash-it dhe shoqeria _____ eshte e interesuar te marre pjese ne kete procedure prokurimi per te paraqitur oferten e saj;
- Dokumentat e fteses per oferte permbajne informacione te natyres teper konfidenciale per Banken. "Informacion konfidencial" do te thote çdo lloj informacioni i derguar nepermjet fteses per oferte per pajisjet e sigurise ne qendren e perpunimit te cash-it, i dhene ne çdo lloj forme, perfshire informacionin e dhene gojarisht, me shkrim, dokument elektronik apo i regjistruar.

Ne dijeni te sa me siper, si marres i informacionit konfidencial angazhohem dhe njoh detyrimet e mia si me poshte:

1. Garantoj te mos perdor informacionin konfidencial qe do te me vihet ne dispozicion nepermjet fteses per oferte ne asnje menyre tjeter pertej qellimit per te cilin me vihen ne dispozicion. Garantoj se me njohjen e informacionit do te respektoj te gjitha standartet dhe parimet e etikes dhe biznesit. Ky informacion do te mbetet konfidencial dhe nuk do te shperndahet ne persona te trete pervecse nese kerkohet nga ligji dhe autoritetet ligjzbatuese.
2. Garantoj se informacioni qe do te me vihet ne dispozicion do te trajtohet ne menyre teper konfidenciale dhe te kujdesshme dhe nuk do te behet publik apo kalohet personave te trete ne asnje rast. Garantoj se do te bej perpjekjet maksimale qe edhe stafi qe do te njihet me kete lloj informacion te vihet ne dijeni te konfidencialitetit te informacionit si dhe pergjegjesise ne rast shperndarje te tij.
3. Garantoj se nuk do te prodhoje kopje te informacionit (perfshire edhe regjistrimin e tij ne nje memorie hardware), te ndryshoje, modifikoj apo te transmetoj ate ne çfaredo menyre apo me çfaredo lloj mjeti. Garantoj se dokumentacioni i cili me vihen ne dispozicion do te fshihet asgjesohet dhe nuk do te ruhet ne asnje forme nga ana ime pas perfundimit te qellimit per te cilin me eshte dhene.
4. Garantoj se ky informacion do te konsiderohet konfidencial per nje periudhe te pacaktuar kohore.
5. Jam plotesisht i qarte qe informacioni qe do te me vihet ne dispozicion mbetet ne pronesi te Bankes dhe se asgje e derguar mes nesh nuk konsiderohet si transferim te drejtash pronesie.
6. Jam plotesisht i qarte i pasojave qe mund te shkaktoje perhapja e informacionit konfidencial si dhe jam dakord te demshperblej Banken per cdo dem te mundshem qe shkaktohet nga nxjerrja e ketij informacioni nga ana jone.
7. Çdo mosmarreveshje qe do te lind nga zbatimi i kesaj deklarate do te zgjidhet prane Gjykates se Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Tirane.

8. Kjo deklarate hartohet ne dy kopje, nga te cilat nje kopje i dorezohet Bankes.

DEKLARUESI
